



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-356

17.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3910/1 datë 27.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4225/4 datë 16.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja Publike Radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Katërt Programor (TVM 4) për shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 5 tetor 2023, nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3910/1 datë 27.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM 4) që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i përmendur, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën vërejtje publike në rastet kur është konstatuar mosrespektim, cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve, përcaktuar me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92 paragrafi (1) të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara të transmetojnë gjatë ditës së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, ndërsa shërbimi publik radiodifuziv së paku 40%.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 27 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4) transmetuar më 5 tetor 2023, në nivel shtetëror, ku u konstatua se shërbimi i katërt programor televiziv i NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4), ka transmetuar 3 orë 29 minuta dhe 16 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është 20.98% e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës, i cili përfshihet në llogaritjen për programt të krijuar burimor (16 orë 37 minuta e 34 sekonda). Minimumi ligjor prej 40 % për transmetim të programit të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me transmetimin total të programit më 5 tetor që hyn në llogaritjen e programit të krijuar burimor (16:37:34), është 6 orë 39 minuta e 1 sekondë. Shërbimi i katërt programor (TVM4) transmetoi për 3 orë 9 minuta e 45 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3910/1 datë 27.10.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM4) më 31.10.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr.10- 3910/2 datë 31.10.2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10- 3910 /1 datë 27.10.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 31.10.2023, për të cilën NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM 4), ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV, nr.y në ark.10 -3910/3 datë 14.11.2023 Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 16.11.2023, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konstatoi që NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM 4) t'i shqiptoi masën – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3910/1 datë 27.10.2023, për konstatim të mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 37-të mbajtur më 16.11.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4225/4 datë 16.11.2023, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i katërt programor (TVM 4) dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendim radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10- 3910/1 datë 27.10.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.